



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Janar, 2025

01-31 Janar, 2025

**PËRMBAJTJA E
BULETINIT**

1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit janar 2024 dhe 2025
2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. COVID-19
7. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

**1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA
SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT JANAR
2025 DHE 2024**

Gjatë muajit janar 2025 janë raportuar **41,613 raste** me sëmundje ngjitëse **Inc.(2,335.03 raste /100, 000 banorë)**. Ky numër i rasteve është më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit **2024 (35,702 raste ose Inc 2,003.35 raste/100,000)**. Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: **Influenca sezonale (ILI) me 32,331 raste ose 1,814.19/100,000 banorë, Diarea akute me 5,751 raste ose 322.71/100,000 banorë, dhe ARI/ITPR me 2,350 raste ose 131.87 në 100,000 banorë (Tab.1).**

Gjatë muajit janar 2025 janë raportuar 13 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 5 raste dg Bronchopneumonia me diagnozë përcjellëse, 4 raste me dg. Influenca A me diagnozë përcjellëse, 3 raste me Infiltratio pulmonum me diagnozë përcjellëse dhe 1 rast me dg. Meningitis acuta.

2. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË SIPAS KOMUNAVE, JANAR 2025

Gjatë muajit janar 2025 në IKShPK, nga grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar, (shih Tabela 1)

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit janar 2025 në IKShPK janë raportuar 32,331 raste me ILI (Inc. 1,814.19/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rritje prej 15.92% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (27,889 raste) dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak, dhjetor 2024 me (12,058 raste të raportuara me ILI) vërehet, rritje e konsiderueshme e numrit të rasteve, karakteristike kjo për sezonën dhe aktivitetet signifikant të qarkullimit të patogjenëve respirator.

Diarea akute: Gjatë muajit janar 2025 në IKShPK janë raportuar 5,751 raste me Diare akute (Inc.322.71/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (4,326 raste), vërehet një rritje prej 32.4% dhe gjithashtu krahasuar me muajin dhjetor 2024, me 4,157 raste të raportuara, rritje prej 38.34%. Megjithatë numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë.

ARI/ITPR: Gjatë muajit janar 2025 në IKShPK janë raportuar 2,350 raste me ARI (Inc.131.87/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (2,260 raste) vërehet një rritje prej 3.98% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak dhjetor 2024 me (1,869 raste) të raportuara, rritje prej 25.73%, rritje e konsiderueshme e numrit të rasteve karakteristike për këtë periudhë të vitit.

Variçella: Gjatë muajit janar 2025 në IKShPK janë raportuar 563 raste me Variçellë (Inc.31.59/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (820 raste) vërehet rënie prej 31.34% e rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak dhjetor 2024 me (478 raste), rënie prej 17.78%.

**Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë,
01 – 31 janar të vitit 2024 dhe 2025**

Tabela 1.

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë				
në periudhën 01 - 31 janar të vitit 2024 dhe 2025				
Sëmundjet	Janar, 2024		Janar, 2025	
	Numri i rasteve	Incidenca/ 100.000	Numri i rasteve	Incidenca/100.000
COVID-19	62	3.48	1	0.06
ITPR - Pneumonia/ARI	2260	126.82	2350	131.87
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	16	0.90	20	1.12
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	27889	1564.94	32331	1814.19
Influenca A	135	7.58	174	9.76
Influenca B	1	0.06	128	7.18
RSV	41	2.30	72	4.04
Diarea acute	4326	242.75	5751	322.71
Variçela	820	46.01	563	31.59
Sindromi meningjeal	13	0.73	14	0.79
Helmimet me ushqim	46	2.58	33	1.85
Salmonella enteritidis		0.00	2	0.11
Infeksionet virale dhe tjera specifike me Rotavirus	3	0.17	4	0.22
Gastroenterokolitet	21	1.18	41	2.30
Hepatiti akut B	4	0.22	3	0.17
Ethe tifoide		0.00		0.00
Morbilli		0.00	3	0.17
Parotiti epidemik		0.00		0.00
Pertussis		0.00	8	0.45
Tularemia	1	0.06	2	0.11
Brucelosis	3	0.17	2	0.11
Echinococcus		0.00	1	0.06
Ethet Q		0.00		0.00
Legionella	1	0.06		0.00
Leishmaniazë	1	0.06		0.00
Sëmundja Lyme (Borelioza)		0.00	1	0.06
TB		0.00	16	0.90
HIV	3	0.17	1	0.06
IST	34	1.91	13	0.73
Giardiaza	4	0.22	1	0.06
Infeksionet streptokoksike të gr. A			8	
*Sëmundjet tjera ngjitëse	18	1.01	70	3.93
Gjithsej	35702	2003.35	41613	2335.03
*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza				

Grupi i sëmundjeve të raportuara në mënyrë individuale:**Sëmundjet vaksinëpreventabile:**

Gjatë muajit janar 2025 janë raportuar 3 raste me Morbill (raste të dyshimta dhe të konfirmuara). Nga gjithsej 14 raste të testuara si raste të dyshimta me Morbill nga laborator i mikrobiologjik i IKShPK-së janë konfirmuar 2 raste pozitive, të hulumtuara me status jo të rregullt vaksinal dhe 1 rast pozitiv i dyshimtë me pasqyrë klinike. Rastet e konfirmuara sipas komunave: Fushë Kosovë (3 raste). Sipas grup-moshës: 12-23 muaj (1 rast) dhe 24-59 muaj (2 raste). Sipas gjinisë 2 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 1 rast i takojnë gjinisë mashkullore.

Gjatë muajit janar 2025 nga gjithsej 9 raste të testuara si raste të dyshimta me Parotit asnjë rast pozitiv nuk është konfirmuar nga Laboratori mikrobiologjik IKShPK. Sa i përket Pertussisit, janë testuar 20 raste të dyshimta dhe janë konfirmuar 8 raste pozitive. Gjatë hulumtimit epidemiologjik kemi siguruar të dhënat se të gjithë kanë status të rregullt vaksinal. Rastet e konfirmuara sipas komunave: Prishtinë (6 raste), Podujevë (1 rast) dhe Istog (1 rast). Sipas grup-moshës: 2-4 vjeç (2 raste) dhe 5-9 vjeç (2 raste), 10-18 vjeç (2 raste) dhe mbi 18 vjeç (2 raste). Sipas gjinisë 5 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 3 raste i takojnë gjinisë mashkullore.

Zoonozat dhe sëmundjet transmise:

Gjatë muajit janar 2025 nga ky grup i sëmundjeve janë raportuar 2 raste me Brucellozë dhe 2 raste në Tularemi. Sipas komunave me Brucellozë (2 rastet janë nga Istogu) ndërsa me Tularemi (1 rast Vushtrri dhe 1 rast Drenas). Nga rastet me Brucellozë një është i gjinisë mashkullore dhe tjetra e gjinisë femërore, po ashtu rastet me Tularemi një është i gjinisë mashkullore dhe tjetra e gjinisë femërore. Sipas moshës rastet i takojnë grup-moshave: 60-69 vjeç (2 raste), 50-59 vjeç (1 rast), dhe 20-29 vjeç (1 rast).

Nga anketimi epidemiologjik: është raportuar një epidemi familjare nga Istogu, me gjithsej 2 raste pozitive, familja në fjalë posedojnë fermë të kafshëve-5 dhi të blera para 2-3 viteve. Kanë konsumuar mish, qumësht dhe djathë nga këto kafshë, por gjithmonë paraprakisht të përpunuara termikisht. Në dhjetor 2024 kanë pasur abort të dhive dhe kanë manipuluar me produkte aborti pa përdorur masa mbrojtëse.

Për shkak se kanë konsumuar qumësht dhe produktet qumështi janë testuar edhe familjarët tjerë por kanë rezultuar negativ. Nga anketimi epidemiologjik i rasteve me Tularemi kuptojmë se pacientë përdorin ujë nga puseta dhe nga bunari si dhe kanë pasur probleme me brejtësit, kanë gjetur minjë në podrumin e shtëpisë.

Gjithashtu nga ky grup i sëmundjeve gjatë muajit janar 2025, është raportuar një rast me Echinococcus, nga komuna e Malishevës, i gjinisë mashkullore dhe i takon grup moshës 10-9 vjeç.

Sëmundjet që barten përmes vektorëve - Gjatë muajit janar 2025 është raportuar një rast me Boreliozë (Lyme Disease) me vendbanim në Prishtinë, i gjinisë femërore që i takon grup moshës 30-39 vjeç.

Sindroma meningjeale:

Gjatë muajit janar, 2025 janë raportuar 14 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 0.78/100 000 banorë), prej tyre 11 raste me Meningjit akut viral, 1 rast me Meningoencephalitis purulenta dhe 2 raste me Meningoencephalitis akut. Ky numër i rasteve të raportuara është pothuajse i njëjtë me periudhën e vitit 2024, ku ishin të raportuara gjithsej 13 raste (9 raste me Meningjit akut viral dhe 4 raste me Meningjit bakterial).

Sipas komunave, 7 raste janë raportuar në komunën e Prishtinës, me nga 2 raste në Drenas dhe Gjakovë, dhe me nga 1 rast komunat: Prizren, Shtime dhe Vushtrri kurse Incidenca më e lartë e rasteve në 100,000 banorë është raportuar nga komuna e Shtimes me 3.55/100,000 banorë. Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezultojnë se numri më i madh i rasteve i takon grup- moshës 0-9 vjeç 50% (7 raste), grup moshë 10-19 vjeç dhe 70-79 vjeç 14.2% (me nga 2 raste) kurse grup moshat

40-49 vjeç, 50-59 vjeç dhe 60-69 vjeç me nga 1 një rast të raportuar (7.1%). Sipas gjinisë, rezulton se 43 % (6 raste) i takojnë gjinisë mashkullore dhe të gjinia femërore me 57% (8 raste).

Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, janë izoluar 12 shkaktarë në LCS, prej tyre: 4 raste Streptococcus pneumoniae, 3 raste me Epstein Barr Virus, 2 raste me HHV 7 dhe me nga 1 rast: Citomegalovirus, Cryptococcus neoformans dhe Varicela Zoster Virus.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim:

Gjatë muajit janar 2025 janë raportuar 41 raste me dg. Gastroenterokolit, 33 raste me dg. Helmin me ushqim, Inc (1.85/100,000 banorë dhe 2 raste të konfirmuara me Salmonella enteritidis (Inc.0.11/100,000 banorë) Tabela 1 dhe 2

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar: 2 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë 2 raste Prishtinë. Sipas grup moshave të dy rastet janë të grup moshës 0-4 vjeç, ndërkaq sipas gjinisë 1 rast është i gjinisë mashkullore dhe 1 rast i gjinisë femërore dhe 2 raste me Enterovirus, prej të cilave sipas komunave janë 2 raste Prishtinë. Sipas grup moshave 1 rast i grup moshës 10-19 vjeç, dhe 1 rast i grup moshës 20-29 vjeç, ndërkaq 2 të dy rastet janë të gjinisë mashkullore.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit janar 2025, u raportuan gjithsej 20 raste me SARI. Të gjithë këta pacientë, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influenca dhe RSV.

Rastet SARI sipas komunave janë Prishtinë (7 raste), Fushë Kosovë (3 raste), Mitrovicë (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Deçan, Drenas, Ferizaj, Obiliq, Pejë, Podujevë, Suharekë dhe Vushtrri. Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : mbi 65 vjeç (12 raste), mbi 80 vjeç (3 raste), 50-59 (2 raste), 40-49 (2 raste) dhe 10-19 (1 rast).

Gjatë muajit janar, 2025 nga qendrat sentinel janë testuar 596 mostra (82.43%) me Influcencë dhe patogjenë tjerë respirator ndërsa nga qendrat jo sentinel 127 mostra (17.56 %) në Influcencë. Prej tyre 174 mostra pozitive në Influcencë A (29.19%), 128 mostra pozitive në Influcencë B (21.47%), 72 mostra me RSV (12.08%), 30 mostra me Human Rhinovirus (5.03%), 21 mostra me Human Adenovirus (3.52%), 5 mostra me Parainfluenca Virus (0.83%) dhe 2 mostra pozitive me Metapneumovirus.

Rastet pozitive me Influcencë A dhe B i përkasin komunave : Prishtinë (99 raste), Mitrovicë (95 raste), Fushë Kosovë (14 raste), Podujevë (13 raste), Obiliq (10 raste), Lipjan (10 raste), Drenas (8 raste), Ferizaj (8 raste), Malishevë (7 raste), Vushtrri (5 raste), Skenderaj (5 raste), Pejë (5 raste), Suharekë (3 raste), Rahovec (3 raste), Shtime (3 raste), Klinë (3 raste), Hani i Elezit (2 raste), Viti (2 raste) dhe me nga një rast komunat : Dragash, Gjakovë dhe Gjilan.

Me RSV : Prishtinë (26 raste), Fushë Kosovë (8 raste), Vushtrri (7 raste), Drenas (6 raste), Malishevë (4 raste), Ferizaj (4 raste), Klinë (3 raste), Podujevë (3 raste), Suharekë (2 raste), Shtime (2 raste), Obiliq (2 raste) dhe me nga një rast komunat :Hani Elezit, Kaçanik, Lipjan, Pejë dhe Prizren.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë raportuar 16 raste me TB, të cilat varësisht konfirmimit dhe strategjisë DOTS (terapisë së observuar direkte) si dhe të dhënave të siguruara nga SMSN do të përditësohen. Gjithashtu nga Infeksionet e grupit A të Streptokokut janë raportuar 8 raste.

Rastet me HIV/AIDS/IST, janar 2025

Gjatë muajit janar 2025, është raportuar një rast me HIV/AIDS. Rasti i takon gjinisë mashkullore, grup mosha 35-44 vjeç, komuna e Prishtinës. Rruga e transicionit e panjohur. Rasti është raportuar përmes SMSN.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht Transmisive (IST), dhjetor 2024

Gjatë muajit janar 2025 janë raportuar gjithsej 13 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Ferizaj 6, Prishtinë 2, Pejë 2, Prizren 1, Mitrovicë 1, Shtime 1. Sipas diagnozës: Chlamydia 9 raste, Condyloma 3, dhe Gonorreja 1 rast. Sipas gjinisë: 11 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 2 raste gjinisë mashkullore. Grup moshës 25-49 vjeç i takojnë 9 raste, grup moshës 15-24 vjeç 3 raste dhe një rast është mbi 50+ vjeç.

Nje rast me Dg. Ano-genital condyloma është raportuar përmes SMSN, nga ana e Klinikës së Dermatovenerologjisë, rastet tjera janë raportuar me anë të postës elektronike dhe me anë të formës raportuese me letër dhe janë sjell në dorë.

Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C, janar 2025

Gjatë muajit janar, 2025 janë raportuar **3 raste** me Hepatit akut B (**Mb. 0.16/100 000 banorë**). Ky numër i rasteve të raportuara është përafërsisht i njëjtë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 ku ishin të raportuara 4 raste me Hepatit akut B. Sipas komunave, janë raportuar me nga 1 rast: Prizren, Mitrovicë dhe Rahovec. Sa i përket grup- moshës, rastet i takojnë grup moshës 20-29 vjeç me 33.3% (1 rast), 40- 49 vjeç me 33.3% (1 rast) dhe grupmosha 50- 59 vjeç me 33.3% (1 rast). Sipas gjinisë rezulton se (2 raste) i takojnë gjinisë femërore dhe (1 rast) gjinisë mashkullore.

Gjatë kësaj periudhe nuk është raportuar asnjë rast me dg. Hepatit akut C.

Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, janar 2025

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave, janar-2025																															
SËMUNDJA	Pneumoni a/ARI	SARI	ILI	Diarrhea ac	Varicell a	Influenc a A	Influenc a B	RSV	COVID- 19	Sindroma meningjeale			Morbilli	Pertussi s	Hepatit ac. B	Helmim et me ushqim	Gastroe nteroko litet	Brucelo za	Tulare mi	Salmo nelloza	Borelioz a (Lyme Disease)	Infeksio net virale dhe infeksio net tjera specifike	Echinoc ocus	IST	HIV	TB	Giardiaz a	Infeksio net streptok oksike të gr. A	Sëm.tjer a ngjitëse	Totali	
										Meningj it serosa	Mening oenceph alit ac.	Mening oenceph alitis purulen ta																			
KOMUNA																															
DEÇAN	7	1	829	44	20																									901	
DRAGASH	61		547	42	1		1																							652	
DRENAS	116	1	590	51	22	8		6		1	1					2	3		1											802	
F. KOSOVË	69	3	1287	199	27	9	5	8					3			3	2												1	1616	
FERIZAJ	16	1	1031	162	13	7	1	4	1							1	4							2			4			1247	
GJAKOVË	71		260	131	4		1			1	1					5	11									2				487	
GJILAN	35		2070	242	23	1		1																						2372	
GRAÇANICË																														0	
H. I ELEZIT	32		319	10		1	1																							363	
ISTOG	16		503	72	5									1				2												599	
JUNIK	0		199	11	1																									211	
KAÇANIK	9		205	33	6			1									1									1				256	
KAMENICË	2		1254	148																										1404	
KLINË	40		194	71	7	3		3									1													319	
KLLOKOT																														0	
LEPOSAVIQ																														0	
LIPJAN	4		172	22	10	5	5	1								1	2													222	
MALISHEVË	7		698	160	15	6	1	4								1														832	
MAMUSHË	27		75	4																						1				107	
MITROVICË	92	2	1428	528	30	31	64								1									1					6	2183	
MITROVICË E VERIUT																														0	
N. BËRDË	0		44	24	0																									68	
OBILIQ	33	1	383	110	11	9	1	2																						550	
PARTESH																1														1	
PEJË	11	1	2398	311	14	5		1																2						2743	
PODUJEVË	24	1	1839	244	121	9	4	3						1			2												1	2249	
PRISHTINË	1387	7	8683	1507	124	62	37	26		7				6		14	14				1	4	1	6	1				4	11891	
PRIZREN	107		3166	771	47	2	2	1				1			1	3								1			6	1	2	1	4112
RAHOVEC	47		134	76	1	3		0							1	1				2										265	
RANILLUG																														0	
SHTËRPCE																										1				1	
SHTIME	9		423	34	2	1		2		1														1		1				474	
SKËNDERAJ	6		283	153	12	4	2									1													1	462	
SUHAREKË	35	1	2070	300	6	3	1	2																						1	2419
VITI	11		879	162	0	1	1																						1	1056	
VUSHTRRI	76	1	428	129	41	4	1	7		1							1		1										59	749	
Z. POTOK																														0	
ZVEÇAN	0		0	0																										0	
BURGU I LIPJANIT																														0	
PAADRESË																														0	
TOTALI	2350	20	32331	5751	563	174	128	72	1	11	2	1	3	8	3	33	41	2	2	2	1	4	1	13	1	16	1	8	70	41613	

*Sëmundjet tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza


3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRI DHE SPITALET RAJONALE NGA SËMUNDJET NGJITËSE NË KOSOVË GJATË MUAJIT JANAR 2025

Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse në numër më të madh janë raportuar nga pneumonitë, infeksionet virale të traktit respiratorë, diaretë akute dhe gastroenterokolitet nga të cilat vetëm disa kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit pasuar nga rastet tjera të cilat raportohen sipas diagnozës klinike. (shih tabela 3).

Rastet e spitalizuara në Klinikën Infektive, Pediatri dhe spitalet rajonale nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë, gjatë muajit janar 2025

Tabela 3.

Sëmundja	Rastet
Pneumonia /ARI	159
SARI	20
ILI	47
Diare dhe gastroenterokolitet	152
Variçella	11
Sindroma meningjeale	14
Hepatitis B	3
Helmimet me ushqim	12
Leptospiroza	1
Fruthi	3
Vulnus morsum viperi	2
Herpes Zooster	1
Mononucleosis	1
Erysipela	8
Exanthema	1
Total	435



4. EPIDEMITË E LAJMËRUARA GJATË MUAJIT JANAR, 2025

Epidemia familjare me Brucellozë në fsh. Gurakoc, Istog

Rasti i parë i Epidemisë familjare nga fhati Gurakoc komuna e Istogut, ka filluar më datë 21.01.2025 është konfirmuar më datë 24.01.2025 dhe 27.01.2025 në laboratorin e Mikrobiologjisë në QRSHP Pejë ku kanë rezultuar pozitiv në testimin në brucellozë, vërtetimi laboratorik në ASHB Pozitiv, WRIGHT 1:640 dy anëtarë të së njëjtës familje: L.K. 1959 dhe E.K. 1956, nga fshati Gurakoc komuna e Istogut. Gjatë hulumtimit epidemiologjik kuptohet se familja posedon kafshë shtëpiake-5 dhi, nga të cilat kanë konsumuar qumësht, djath. Kafshët janë blerë para 2-3 vitesh dhe në dhjetor 2024 kanë pasar abort të kafshëve dhe pacientët kanë manipuluar me produkte aborti pa masa mbrojtëse. Pos tyre produkte nga këto kafshë kanë konsumuar edhe 2 vajzat, nipat dhe mbesat por të cilët në testim kanë rezultuar negativ. Shenjat klinike: lodhje, plogështi e theksuar, djersitje natën, dhembje shpindë. Situata mbetet nën mbikqyrje të vazhdueshme epidemiologjike dhe presim rezultate nga testimi i kafshëve.

Masat e ndërmarra: trajtimi ambulantor në QKMF Istog dhe ambulance private, anketimi epidemiologjik, testimi i të sëmurëve dhe personave të dyshimtë, edukim shëndetësor, është njoftuar AUV. Situata mbetet nën mbikqyrje të vazhdueshme epidemiologjike dhe në pritje të rezultateve nga testimi i kafshëve

5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE


Për këtë periudhë, kanë raportuar 30 komuna ose 78.9% (30/38) e tyre. Komunitatet të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Kllokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok.

6. COVID-19

Gjatë muajit janar 2025, janë testuar 755 mostra të dyshimta në COVID-19 dhe prej tyre është raportuar 1 rast pozitiv me SARS-CoV-2 me një shkallë të pozitivitetit prej 0.13%. Krahësuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 (62 raste pozitive të raportuara), vërehet ulje e rasteve pozitive. Gjatë muajit janar 2025 nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes nga COVID-19. (Grafikoni 1). Rastet pozitive, sipas komunave një rast: Ferizaj me grup-moshë: 0-9 vjeç e gjinisë femër.

Në Kosovë varianti i SARS-CoV-2 Omicron BA.2.86 dhe subvariantet e tij, përfshirë KP.3, dominojnë në mesin e mostrave të testuara pozitive në virusin SARS CoV-2, në periudhën një-mujore nga 10 Korrik deri 9 Gusht 2024. Nga variantet kemi: 53% për Variantin KP.3 (44 detektimet) dhe 47% për Variantin BA.2.86 (39 detektimet). Rrjedhimisht, prania e nën-linjave të variantit të Omicronit të SARS-CoV-2 në Kosovë është në përputhje të përafërt me epidemiologjinë virologjike të SARS-CoV-2 në vendet tjera Europiane, përkatësisht me dominim të variantit KP.3. Aktiviteti i SARS-CoV-2 ka pësuar një rënie, me nivele pozitiviteti më të ulëta krahasuar me vitin 2023. Situata mbetet e ndryshme në nivel të të gjitha shteteve raportuese, me individët mbi 65 vjeç më të prekur nga sëmundjet e rënda të COVID-19

Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara, të konfirmuara me COVID-19, janar 2025



7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE BOTË, JANAR 2025

Transmetimi i virusit të Mpox clade I në regjionin e Evropës

Gjithsej njëmbëdhjetë raste MPXV clade Ib janë raportuar në BE/EEA që nga gushti 2024. Më 15 gusht 2024, Suedia raportoi rastin e parë të importuar të mpox për shkak të MPXV clade Ib në vendet e BE/ZEE. Shtatë raste janë raportuar nga Gjermania (një në tetor, pesë në dhjetor 2024 dhe një në janar 2025), dy raste nga Belgjika në dhjetor 2024 dhe një rast nga Franca në janar 2025. Të gjithë individët kishin sëmundje të lehtë.

Ngjarje të konfirmuara të transmetimit dytësor u raportuan nga Gjermania dhe Belgjika. Në Gjermani, tre individë (përfshirë dy fëmijë) ishin kontakte familjare të një rasti indeks me një histori udhëtimi në një vend të prekur. Në Belgjikë, një fëmijë ishte kontakt familjar i një rasti indeks me një histori udhëtimi në një vend të prekur. Transmetimi dytësor i konfirmuar i mpox për shkak të MPXV clade I jashtë kontinentit afrikan është raportuar gjithashtu nga Mbretëria e Bashkuar dhe Kina. Numri i rasteve dytësore të raportuara jashtë vendeve afrikane të prekura varion nga një deri në katër individë për ngjarje. Bazuar në informacionin e disponueshëm, të gjitha ngjarjet e transmetimit ishin për shkak të kontaktit të ngushtë me rastet indeks

Transmetimi në komunitet i MPXV clade I është raportuar vetëm në vendet afrikane të prekura. Shumica e rasteve të klasit I në Afrikë janë raportuar nga Republika Demokratike e Kongos (DRC), Burundi dhe Uganda. Në vitin 2024, DRC raportoi mbi 40 000 raste, mbi 9 000 prej të cilave janë konfirmuar dhe mbi 40 vdekje. Burundi raportoi mbi 3 000 raste të konfirmuara dhe Uganda mbi 1 500 raste të konfirmuara. Një numër më i ulët i rasteve mpox clade I u raportua nga Ruanda, Kenia, Zambia dhe Zimbabve.

Jashtë kontinentit afrikan, janë raportuar vetëm raste të lidhura me udhëtimet për shkak të MPXV klade I dhe/ose raste sporadike me lidhje epidemiologjike me raste të lidhura me udhëtimin. Asnjë transmetim më i gjerë i komunitetit dhe asnjë vdekje nuk është raportuar për shkak të MPXV clade I në asnjë vend jashtë Afrikës.

Bazuar në një analizë të modeleve të transmetimit MPXV të vëzhguara në nivel kombëtar dhe duke marrë parasysh kufizimet dhe pasiguritë, ECDC ka klasifikuar vendet ku MPXV kladi I është endemik ose është raportuar për herë të parë në 2024.

MPXV clade II vazhdon të qarkullojë globalisht. Jashtë Afrikës, MPXV clade II qarkullon kryesisht midis meshkujve që bëjnë seks me meshkuj. Pas shpërthimit të madh të MPXV clade II në 2022, numri i rasteve të raportuara në BE/EEA ka variuar nga dy në 151 në 2023 dhe nga 67 në 221 në muaj në 2024.

Influenza A(H5N1) –Monitorimi i rasteve humane

Më 27 janar 2025, Agjencia e Sigurisë Shëndetësore e Mbretërisë së Bashkuar (UK HSA) publikoi një deklaratë për shtyp që konfirmon një rast të gripit A(H5N1) në një person në rajonin West Midlands. Rasti u konfirmua në laboratorin kombëtar të referencës më 24 janar 2025. Personi i infektuar kishte kontakt të ngushtë dhe të zgjatur me një numër të madh zogjsh të infektuar në një fermë. Më 29 janar 2025, sekuenca A/England/0480160/2025 (EPI_ISL_19695821) u depozitua në GISAID EpiFlu. Kladi është 2.3.4.4b dhe gjenotipi i dhënë është DI.2, i cili është i ndryshëm nga gjenotipet B3.13 dhe D1.1, të përcaktuara nga një konventë tjetër emërtimi, që u identifikuan për rastet e influencës së shpendëve njerëzor në SHBA në vitin 2024. Analiza filogjenetike e rasteve HAstrain në SHBA konfirmon që nga rasti i gjenetisë njerëzore në MB është i ndryshëm nga rasti i HAstrain në SHBA shtame të mbledhura nga zogjtë në Evropë në 2024 dhe 2025. Në veçanti, segmenti HA i A/England/0480160/2025 është pothuajse identik me atë të një shtame të mbledhur më 18 janar 2025 nga një pulë nga MB. Segmenti PB2 i A/England/0480160/2025 ka I292V i cili shoqërohet me rritjen e aktivitetit të polimerazës në linjën

qelizore të gjitarëve dhe rritjen e virulencës tek minjtë (e testuar në nëntipet H10N8 dhe H9N2). Megjithatë, ky mutacion është shumë i zakonshëm edhe në shtamet e izoluar nga shpendët. Sipas njoftimit për shtyp, zogjtë në fermën e ekspozimit ishin gjithashtu të infektuar me gjenotipin DI.2, një nga viruset që dihet se qarkullojnë midis gjitarëve dhe shpendëve në Shtetet e Bashkuara. Rasti përjetoi simptoma të lehta të frymëmarrjes dhe sy të irrituar. Individit aktualisht është mirë dhe u shtrua në një njësi të sëmundjeve infektive me pasoja të larta (HCID) për izolim. Aktivitetet e gjurmimit të kontakteve janë në vazhdim dhe kontakteve me rrezik të lartë u janë ofruar ilaçe antivirale. Një kontakt simptomatik familjar ka rezultuar negativ. HSA e Mbr Raste sporadike humane të nëntipave të ndryshëm të gripit të shpendëve A(H5Nx) janë raportuar më parë globalisht. Provat aktuale epidemiologjike dhe virologjike sugjerojnë se viruset A(H5N1) mbeten të ngjashme me shpendët. Transmetimi të njerëzit mbetet një ngjarje e rrallë dhe nuk është vërejtur asnjë transmetim i qëndrueshëm midis njerëzve. Në përgjithësi, rreziku i transmetimit të gripit zoonotik tek publiku i gjerë në vendet e BE/ZEE konsiderohet i ulët. Rreziku për grupet e ekspozuara në profesion, si fermerët dhe vrasësit, konsiderohet i ulët deri në mesatar. Kontakti i drejtpërdrejtë me zogjtë e infektuar ose një mjedis të kontaminuar është rruga më e mundshme e infeksionit dhe përdorimi i masave mbrojtëse personale për njerëzit e ekspozuar ndaj zogjve të ngordhur ose jashtëqitjeve të tyre do të minimizojë rrezikun. Rastet e rënda të fundit në Azi dhe Amerikë të fëmijët dhe njerëzit e ekspozuar ndaj shpendëve të infektuar, të sëmurë ose të ngordhur në oborrin e shtëpisë nënvizojnë rrezikun e kontaktit të pambrojtur me zogjtë e infektuar në mjediset e fermave të oborrit të shtëpisë. Kjo mbështet rëndësinë e përdorimit të pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale.

Chikungunya (Morbus viral)

Që nga fillimi i vitit 2025 mbi 5 000 raste CHIKVD dhe 2 vdekje janë raportuar në katër vende në mbarë botën (tre vende në Amerikë dhe një në Evropë). Në vitin 2024, 620 000 raste CHIKVD dhe 213 vdekje u zbuluan përmes aktiviteteve të inteligjencës epidemike nga vendet në Amerikë (15), Azi (6), Afrikë (1) dhe Evropë (1).

Asnjë rast autokton i CHIKVD nuk është raportuar në Evropën kontinentale në vitin 2025. Megjithatë, 138 raste të CHIKVD janë raportuar nga departamenti i jashtëm francez i La Réunion.

Amerika po përballët aktualisht me shpërthimin më të madh ndonjëherë të dengës. Si rezultat, ka pasur një rritje të konsiderueshme në numrin e rasteve të importuara të dengës në BE/EEA që nga fillimi i vitit 2024.

Mundësia e transmetimit të mëtejshëm të virusit të dengës dhe chikungunya në kontinentin BE/ZEE është e lidhur me importimin e virusit nga udhëtarët viremikë në zonat pritëse me vektorë kompetentë të vendosur dhe aktivë (p.sh. *Aedes albopictus* dhe *Aedes aegypti*). *Aedes albopictus* është krijuar në një pjesë të madhe të Evropës. Në Evropë dhe zonat fqinje, *Aedes aegypti* është themeluar në Qipro, në brigjet lindore të Detit të Zi dhe në rajonin më të largët të Madeira.

Kushtet mjedisore në zonat e BE/ZEE ku *Ae. albopictus* ose *Ae. Aegypti* janë aktualisht janë të pafavorshme për aktivitetin e mushkonjave dhe riprodhimin e virusit tek mushkonjat; prandaj, nuk ka gjasa që transmetimet e virusit të chikungunya-s dhe dengës së fituar në vend të ndodhin derisa kushtet të bëhen të favorshme në fillim të verës. Të gjitha shpërthimet autoktone të kaluara të CHIKVD dhe dengës në kontinentin e BE/EEA kanë ndodhur deri më tani midis qershorit dhe nëntorit.

8. REKOMANDIMET

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHIP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Inspektorët shëndetësor dhe sanitar të bëjnë mbikëqyrjen e sistemit të raportimit të sëmundjeve ngjitëse, bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200 për mënyrën e regjistrimit/raportimit të sëmundjeve ngjitëse në të gjitha Institucionet shëndetësore.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave dhe pasqyrës reale të situatës epidemiologjike në kohë reale për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes. (Gjatë muajit janar 2025 përmes SMSN janë raportuar 132 raste të sëmundjeve ngjitëse)

Sëmundjet zoonotike dhe ato që përcillen nga vektorët në Kosovë po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme dhe po ndryshojnë pasqyrën e ngarkesës nga sëmundjet ngjitëse, prandaj rekomandojmë bashkëpunimin ndërsektorial dhe themelimin e komitetit për shëndetin human, animal dhe mjedisor “Një shëndet”.

INSITUTI KOMËTAR I SHËNDETËSISË**PUBLIKE TË KOSOVËS****Departamenti i Epidemiologjisë****Adresa: Rr. Nëna Terezë (p.n) rrethi i spitalit, Prishtinë 10000****WebFaqe: <http://www.niph-rks.org>****E-mail: ariana.kalaveshi@rks-gov.net****Telefoni+38338 551432, ext. 1013**



